

## Akti i Themelimit

### "GD-PETROL"

#### Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot, më datë 08/03/2023 i nënshkruari:

- **Z. Mariklejdi Marku, i biri i Llesh dhe Dilë** lindur më 22/07/1996, banues në rrugën Gjokaj, Nd 12, H1. Shëngjin ,Ishull-Shëngjin, 4503, Lezhë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J60722045H.

Me vullnetin tim të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "(Ligj i Shoqërive) kam vendosur të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "GD-PETROL " (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

#### Emri dhe forma ligjore

##### Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë "GD-PETROL " ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k., cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(Ligji i Shoqërive

#### Selia dhe kohezgjatja

##### Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Vau Dejës, krahu i djathtë, km-7, nr.pasurie 115/32, zk. 1898 Gur i Zi, Shkodër.** Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të vetëm

#### Objekti i veprimtarisë

##### Neni 3.

- 3.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor: **Tregtim me pakicë karburanti dhe vajra lubrifikante, tregtim artikuj të ndryshëm, lavazh ,bar-kafe, mëngjezore**

- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë sic parashikohet në këtë Akt.

#### Kapitali Themeltar

##### Neni 4.

- 4.1. Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 100.000 (Njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me një vlerë nominale 100.000 (Njëqind mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit.
- 4.2. Ortaku i vetëm themelues:
- **Z. Mariklejdi Marku, i biri i Llesh dhe Dilë, lindur më 22/07/1996, banues në rrugën Gjokaj, Nd 12, H1. Shëngjin, Ishull-Shëngjin, 4503, Lezhë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J60722045H, zotërues i një kuote të barabartë me vlerë nominale 100%.**

#### Organet drejtuese dhe Administrimi

##### Neni 5.

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:
- Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
  - Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë: **Z. Mariklejdi Marku** i cili e merr këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejte rinovimi.

#### Dispozita Përfundimtare

##### Neni 6.

- 6.1 Cdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i vetem i Shoqërisë, sot më datë 08/03/2023 gjuhën shqipe në dy kopje.

ORTAKU THEMELUES  
Mariklejdi Marku

